



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 21 , Datë 8/11/2012

Bazuar në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

**KONSTATON:**

Mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", në fund të procedurës së hetimit ka dalë Vendimi nr. 13 datë 30.07.2012, me anë të të cilit është vendosur konstatimi i diskriminimit të znj .naj. Në pikën 2 të këtij vendimi Komisioneri ka rekomanduar ndreqjen e shkeljes ligjore përmes kthimit në gjendjen e mëparshme. Palët e interesuara kanë marrë dijeni për vendimin.

Bazuar në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", si dhe në pikën 3, të Vendimit nr. 13 datë 30.07.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria Rajonale Shëndetësore Fier, duhet të raportonte, brenda 30 ditëve, para Komisionerit për veprimet e marra për zbatimin e këtij vendimi duke bërë me dije Komisionerin për masat e marra.

Me shkresën Nr.Prot. 628, datë 17.09.2012, Drejtoria Rajonale Shëndetësore Fier, i drejtohet Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por nga përmbajtja e shkresës, nuk raportohet asnjë veprim i ndërmarrë për të zbatuar vendimin nr. 13 datë 30.07.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në këtë shkresë njoftohet Komisioneri se kjo çështje po zgjidhet në rrugë ligjore pranë Gjykatave të Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykatës së Apelit Vlorë. Ju bëjmë me dije se Vendimi nr 90(62-2012-292) datë 19.01.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier si dhe Vendimi nr 62-2012-5296 (1729) datë 18.09.2012 po i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nuk kanë objekt të padisë çështjet diskriminuese gjë që mund të sillte pushimin e shqyrtimit të çështjes nga ana e Komisionerit deri në përfundim të këtyre proceseve.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Sa më sipër Komisioneri arrin në konkluzionin se Drejtoria Rajonale Shëndetësore Fier, është në shkelje të parashikimeve të bëra në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", pasi nuk ka zbatuar vendimin nr. 13, datë 30.07.2012 të Komisionerit.

### PËR KËTË ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa "ç", nenin 33, pikat 11,12,13/ç e 14 të ligjit nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### VENDOSI:

1. Drejtoria Rajonale Shëndetësore Fier, të gjobitet me gjobë në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.
2. Gjoha të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda datës 05 Dhjetor 2012.
3. Zbatimi i vendimit nr. 13 datë 30.07.2012 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda shtatë ditëve nga marrja dijeni për sanksionet, sjell shfuqizimin e tyre.
4. Subjekti Drejtoria Rajonale Shëndetësore Fier, duhet të njoftojë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përputhje me sa parashikohet në pikën 3, të këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.



11/11  
439 Prut  
8.11.2012



Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)